

ÇOHU!

PËRSIATJA E DËSHTUAR

FINANCIMI
I PARTIVE
POLITIKE NË
KOSOVË

ANALIZË
POLITIKASH

DHJETOR, 2016



Organizata për
Demokraci, Antikorrupsion
dhe Dinjitet, Çohu!

PËRSIATJA E DËSHTUAR



**FINANCIMI
I PARTIVE
POLITIKE NË
KOSOVË**



ANALIZË POLITIKASH

Kjo analizë është mundësuar me mbështetje të
KFOS- Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur



Deklaratë mohimi:

Përmbajtja e kësaj analize është përgjegjësi e plotë e Organizatës Çohu!, dhe rrjedhimisht nuk reflekton qëndrimet e donatorëve të projektit

Autorë:

Altin Ademi dhe Arton Demhasaj

Lekturoi:

Besa Kalaja

Originali është shkruar në shqip

Publikuar nga:

Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe
Dinjitet, Çohu!
Rruga: Rrustem Statovci Nr.17; Prishtinë, Kosova
Tel / +381 (0)38 248 506
www.cohu.org



PËRMB

1 **08**

**Përmbledhje
Ekzekutive**

2 **10**

Metodologjia

3 **11**

**Financimi i
Partive Politike
në Kosovë –
Baza Ligjore**

3.1 Natyra e financimit

**3.2 Shkalla e
transparencës
dhe ndërlidhjet e
bizneseve me
partitë politike**

AJTJA



4

25

**Tre modele të
financimit të
partive politike**

4.1 Franca

4.2 SHBA

4.3 Norvegjia

5

30

**Përfundime
analitike dhe
rekomandime
themelore**

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Partitë politike si aktore të zhvillimeve shoqërore e politike kanë një ndikim të konsiderueshëm në përgjithësi, veçanërisht në vendet në konsolidim e sipër të demokracisë. Ato shpesh herë shihen si modele me anë të së cilave shoqëria shtron vizionin e vet zhvillimor dhe ideologjik për të tashmen dhe të ardhmen. Kësaj trajektoreje nominalisht nuk do të duhej t'i kishte ikur as Republika e Kosovës, sidomos për faktin se terminologjia e politikës në shoqërinë kosovare është shumë ngushtë e lidhur me partitë politike. Madje në të shumtën e rasteve, konceptimi i politikës në Kosovë nuk ka ndërtuar një strukturë më të gjerë sesa aktivitetet, lidhshipi dhe struktura e partive politike, duke i vendosur ato si faktorët primar të zhvillimeve të karakterit politik. Shpeshherë edhe vetë konceptimi i shtetit si organizim është i lidhur ngushtë me partitë në pushtet.

Rrjedhimisht, duke pasur për bazë këtë ndikim të madh të partive politike në jetën dhe zhvillimin e shoqërisë së Kosovës, është mjaft e arsyetuar kërkesa qytetare për të pasur transparencë dhe qasje të hapur ndaj mënyrës së si partitë politike funksionojnë, si ndërtojnë agjendat e tyre, si organizojnë ciklet e tyre të përfshirjes dhe veçanërisht, në kuadër të funksionimit të tyre, si financohen ato.

Punimi në vazhdim ka për qëllim të sjellë një perspektivë mbi financimin e partive politike në Kosovë duke pasur për bazë tre realitete të etabluara:

- a) **Mungesa e Auditimit të Financave të Partive Politike.** Megjithëse partitë politike dorëzojnë raportet financiare të tyre për auditim tek Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dhe megjithëse ekziston një formulë për të përcaktuar auditorët e subjekteve politike, që nga hyrja në fuqi e ligjit përkatës, financat e subjekteve politike nuk janë audituar asnjëherë.



Raportet e Progresit të BE-së për Kosovën për vite me radhë kanë kritikuar dhe bërë thirrje për një transparencë në financimin e partive politike, si bazë për të disiplinuar kështu edhe marrëdhënie të ndryshme që rrjedhin nga raporti donatorë-parti.

Duke pasur për bazë këtë mungesë të auditimit të financave, është shkëputur kontrolli, monitorimi dhe lidhja logjike në mes të donatorëve të ndryshëm të partive si dhe shpenzimet e tyre gjatë fushatave zgjedhore. Mbi këtë diskurs, aktualisht nuk mund të identifikohen donatorët e partive politike dhe nuk mund të tërhiqen paralele të nevojshme për të shikuar shkallën e përgjithshme të përkthimit të ndikimit të këtyre donatorëve në sferën e përfitimit publik, veçanërisht ndërlidhjen e tyre si sfera interesi me dikasterët që udhëheqin partitë përfituese;

b) **Kritikat dhe Standardet Ndërkombëtare.**

Raportet e Progresit të BE-së për Kosovën për vite me radhë kanë kritikuar dhe bërë thirrje për një transparencë në financimin e partive politike, si bazë për të disiplinuar kështu edhe marrëdhënie të ndryshme që rrjedhin nga raporti donatorë-parti. Po ashtu, përderisa ka një kornizë ligjore dhe ka edhe standarde të mirëfillta të transparencës së partive politike parë nga perspektiva globale, mbetet e pakuptimtë që partitë politike në Kosovë të mbesin jashtë aplikimit të këtyre standardeve;

c) **Mos-implementimi i Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike.**

Pavarësisht se struktura ligjore përcakton një model të caktuar të financimit, njeh kategoritë e mundshme të financimit dhe përcakton edhe masa disiplinore kundrejt mungesës së transparencës, ligji për financimin e subjekteve politike mbetet ndër ligjet më të pazbatuara në nivel vendi si pasojë e faktorëve në rang institucional, socio-ekonomik dhe më gjerë;

Duke konsideruar këto realitete si pjesë e përditshmërisë që karakterizon jetën institucionale dhe formale të partive politike, punimi në vazhdim sjellë në pah disa prej të gjeturave themelore që e deshifrojnë realitetin ekzistues, ndër të cilat:

- 1 Shkalla e implementimit të legjislacionit përkatës;
- 2 Standardet bashkëkohore të financimit të partive politike;
- 3 Niveli i transparencës së financave;
- 4 Modele krahasuese se si mund të rregullohet ky proces;
- 5 Gatishmëria e partive politike për t'iu nënshtruar një menaxhimi dhe transparencë më të madhe;
- 6 Deshifrimi i relacioneve në mes donatorëve-partive dhe pushtetit;
- 7 Autoritetet publike që do të mund të ndikojnë në këtë agjendë; etj.

Duke konsideruar demokratizimin e shoqërisë të lidhur ngushtë me vetë demokratizimin e partive politike dhe duke pritur që të njëjtat të funksionojnë konform normave dhe standardeve të mirëfillta, ideja prapa kësaj analize ka për qëllim që të stimulojë diskutimin mbi deficitet e përgjithshme që e karakterizojnë këtë fenomen, veçanërisht për faktin se partitë politike janë faktorë të rëndësishëm në krijimin e perspektivës së zhvillimit të shoqërisë në rrafshin politik.

2. METODOLOGJIA

Duke pasur për bazë natyrën e problemit që shtrohet në këtë analizë, baza teorike dhe konceptuale e hartimit është ndërtuar përmes pikëpamjes teorike të **Institucionalizimit Normativ**.¹

Punimi në përgjithësi është hartuar përmes një qasje të kombinuar kualitative-kuantitative. Tipologjia e metodave të përdorura për hartimin e tij përfshijnë:

a) Shqyrtimi në tavolinë (Desk review). Gjatë fazës përgatitore të punimit, janë shqyrtuar raportet e ndryshme që flasin për temën e shtruar. Janë hulumtuar dhe referuar si realitete raportet e progresit të BE-së, raportet e auditimit të financave të partive para hyrjes në fuqi të ligjit, raportet e ndryshme të shoqërisë civile që flisin për probleme të theksuara të kësaj natyre, si dhe janë konsultuar përvojat e ndryshme perëndimore me theks të veçantë në tri modelet që janë prezantuar si krahasim;

b) Intervistat. Gjatë realizimit të këtij punimi janë intervistuar akterë të ndryshëm të konsideruar si kontributdhënës për nxjerrjen e të dhënave dhe vlerësimeve të nevojshme në arritjen e përfundimeve analitike, që reflektojnë realitetin ekzistues. Në këtë rrafsh, janë intervistuar zyrtarët e partive më të mëdha parlamentare si PDK, LDK, AAK, Vetëvendosje!, si dhe akterë të tjerë nga shoqëria civile dhe sektori i biznesit privat.

¹ Teoria e cila fokusohet në zhvillimin e një pikëpamje sociologjike mbi institucionet –mënyrën si zhvillohen ato dhe si ndikojnë në shoqëri.

3. FINANCIMI

I PARTIVE

POLITIKE NË

KOSOVË –

BAZA LIGJORE

Për të funksionuar, partitë politike siç edhe ekziston praktika e tillë pothuajse në çdo vend, kanë nevojë për mjete financiare në mënyrë që të realizojnë agjendat e tyre dhe të sigurojnë administrimin e mirëfilltë. Tradita e pluralizmit politik në Kosovë ka filluar që nga vitet 90-ta dhe pavarësisht karakteristikave të përgjithshme politike, Lidhja Demokratike e Kosovës që asokohe ishte partia politike e formatit të lëvizjes popullore, ishte financuar tërësisht nga qytetarët, qoftë si entitete biznesi, qoftë nga të ardhurat nga diaspora apo edhe kontributet e ndryshme. Pas përfundimit të luftës, u rrit ndjeshëm diversiteti në kuptim të numrave të partive politike që filluan të organizohen politikisht. Megjithatë, baza e parë

ligjore që trajtoi çështjen e financimit të partive dhe bërjen transparente të financuesve të tyre ishte një rregullore e UNMIK-ut² e vitit 2004 e cila sanksiononte kushtet mbi të cilat një parti politike mund të pranojë donacione. Shtyllat bazë të kësaj rregulloreje ishin me theks të veçantë të vendosura në nenin 16, pika 16.2 e cila sanksiononte çdo pranim të mjeteve nga palë të paidentifikuara përmes emrit dhe numrit personal të identitetit si dhe pika 16.3 e cila sanksiononte kontributet e dhëna në mënyrë të tërthortë

2. Urdhëresa Administrative 2004/01 e UNMIK, për zbatimin e Rregullores 2000/16 të UNMIK për Regjistrimin dhe Veprimtarinë e Partive Politike në Kosovë: http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2004regs/RA2004_11.pdf

përmes një personi nga paratë, pasuria apo shërbimet e palës së tretë, paraqesin dy shtylla bazë për sigurimin e transparencës së financimit. Me gjithë vendosjen e kësaj baze ligjore për mbikëqyrjen e financave të partive politike, përgjegjëse për zbatimin e kësaj baze ligjore ishte Zyra e UNMIK në kuadër të Shtyllës së Katërt të Qeverisjes, gjë që na sugjeron se duke pasur në konsideratë marrëdhëniet e përgjithshme socio-politike në mes të mandatit të UNMIK-ut dhe faktorëve politik në Kosovë, asnjëherë nuk ka pasur një mbikëqyrje të mirëfilltë dhe të thelluar të burimeve të financimit të partive. Në një raport të OSBE-së të publikuar në maj të vitit 2004, theksohet se partitë politike regjistruar dhe raportimet e para financiare i kanë bërë për periudhën 2002-2003, me gjithë faktin se të njëjtat ishin vetëm raporte të shpenzimeve dhe kishin karakter administrativ-deklarativ më shumë sesa përmbajtësor.³ Si rrjedhojë, gjatë kësaj faze partitë politike fillimisht si mungesë e një tradite institucionale, përvojës dhe gatishmërisë për të vendosur baza të forta institucionale brenda për brenda mënyrës së funksionimit të tyre, kanë mundur të vazhdojnë të financohen nga burime të ndryshme pa rënë pre e disiplinimit siç ishte e përcaktuar me këtë bazë ligjore.

Ndryshimet politike që sollën shpalljen e pavarësisë së vendit në shkurt të vitit 2008 dhe konsolidimi i shtetësisë në rrafshin e brendshëm, sidomos në aspektin legjislativ, e solli në agjendë edhe një herë çështjen e financimit të partive politike kur në Kuvendin e Kosovës u miratua Ligji nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike.⁴ Karakteristikat kryesore të këtij ligji ishin kategorizimet e burimeve të financimit,⁵ format legale të financimit dhe masa e financimit të partive nga personat fizikë dhe juridikë. Sipas këtij kategorizimi, partitë politike mund të financohen nga:

- a) Kuotat e anëtarësisë;
- b) Kontributet;
- c) Financimi nga Buxheti i Republikës së Kosovës;
- d) Çdo pasuri e fituar në mënyrë të paraparë me këtë ligj; dhe
- e) Të ardhurat nga aktivitetet e subjektit politik siç janë publikimet, botimet, shitja e materialeve reklamuese etj.

Pjesa përmbajtësore që vendosë bazën e transparencës së financimit lidhte partitë politike me obligime ligjore jo vetëm për të deklaruar burimet e financimit por edhe për të ofruar dëshmi të prejardhjes së tyre,⁶ në të kundërtën, dorëzimin e mjeteve në buxhetin e Republikës së Kosovës. Në sanksionimet e mënyrës së financimit, Ligji përcaktonte se partitë politike në Kosovë nuk mund të financohen nga institucionet qeveritare dhe joqeveritare të huaja; personat fizikë dhe juridikë të huaj; personat anonim fizikë dhe juridikë; donatorët anonim; institucionet dhe ndërmarrjet me kapital të fituar nga bixhozi, bastoret dhe lojërat e ndryshme të fatit, si dhe nga entet vendase publike ose me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror.⁷ Në vijë me këtë, ishte edhe Neni 12 i cili ndalonte format e presionit për përfitim të donacioneve, përfshirë edhe premtimin për privilegje apo përfitime personale kundërligjore ndaj donatorit. Masat e sanksionimit parashihnin edhe dënimet me gjobë për shkelje të dispozitave të këtij ligji duke filluar nga 1,000 deri në 10,000 euro për subjekte dhe 500 deri në 3,000 euro për kandidatë.⁸ Duhet theksuar se burimet e financimit nga donatorët sipas modelit që parasheh ligji janë të kufizuara, përkatësisht një donator me status juridik mund të dhurojë donacion jo më të madh se 10,000 euro brenda një viti ndërsa për subjekt fizik kjo shumë është 2,000 Euro.⁹ Me gjithë përcaktimet e

3 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE) Misioni në Kosovë: Raport mbi Raportet Financiare Vjetore të Partive Politike për Vitet 2002-2003, Maj 2004: <http://www.osce.org/sq/kosovo/33450?download=true>;

4 Ligji nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-174-alb.pdf>

5 Neni 4 përcaktonte burimet e financimit të partive politike;

6 Neni 5, pika 2 dhe 3 e Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike: “Subjekti politik i cila pranon një kontribut, origjinën dhe prejardhjen e të cilit, kontributdhënësi, nuk mund ta dëshmojë, detyrohet, që brenda dy (2) javë, t’i njoftojë organet kompetente për vërtetimin e prejardhjes së këtij kontributi”; “Nëse nuk mund të dëshmohet prejardhja e kontributit, kjo vlerë mbetet në Buxhetin e Republikës së Kosovës”; <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-174-alb.pdf>;

7 Neni 11 i Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike; <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-174-alb.pdf>;

8 Neni 21 i Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike; <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-174-alb.pdf>;

9 Neni 5, pika 1.1 dhe 1.2; <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-174-alb.pdf>;

modelit të financimit të partive sipas dispozitave të këtij ligji, pjesa që mungon për t'i dhënë kuptim të plotë juridik janë kompetencat që ndërlidhen me zbatimin e tij. Sipas ligjit, zbatimi i tij do të monitorohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës. Por kompetencat e këtij mekanizmi mbikëqyrës që janë përcaktuar me këtë ligj janë kryesisht të natyrës administrative. KQZ-ja ka për mandat pranimin dhe certifikimin e raporteve financiare si raportimin e tyre në Kuvendin e Kosovës. KQZ-ja ka mandat edhe për të shqiptuar gjokat, indicet e të cilave lidhen vetëm me shkeljet e afateve të raportimit të financave. Megjithatë, ligji nuk përcakton një autoritet të mirëfilltë që bartë përgjegjësinë e zbatimit të këtij ligji në kuptimin e përgjithshëm të fjalës. Konkretisht, ligji nuk parasheh një mandat hetimi të prejardhjes së donacioneve dhe nuk parasheh një trup që do të merrej me verifikimin më të hollësishëm nëse të gjitha mjetet që pranojnë partitë politike nga donatorët, pranohen konform dispozitave ligjore.

Pas miratimit të ligjit, logjika e transparencës më të madhe si duket u vu në pah dhe u shtrua si nevojë për çfarë edhe u miratua Ligji nr.04/L-58 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike¹⁰ në vitin 2012. Ndër ndryshimet më thelbësore që reflektonin edhe kritikën më të mëdha në lidhjen e financimit të partive politike me kompanitë dhe bizneset që përfitonin kontrata publike, ishte Neni 5 i tij i cili sanksiononte donacionet nga dhuruesi i cili në mënyrë të qartë mund të përfitojë një avantazh ekonomik.¹¹ Po ashtu u përcaktua edhe pranimi i mjeteve nga donatorët përmes llogarive bankare. Ligji i ri po ashtu rriti shkallën e gjobave për shkeljet eventuale të dispozitave të ligjit bazik si dhe në linjë me rritjen e transparencës, sanksionoi një kategori të papërcaktuar gjobe që do t'u jepet partive në shkallë të trefshit të mjeteve të çdo shume mbi 20 mijë euro për të cilat partitë nuk mund të dëshmojnë prejardhjen e tyre.¹²

Me gjithë ndryshimet e bëra këto norma ligjore nuk prodhuan ndonjë efekt konkret që do të mund të ndërtonte një përfytyrim real mbi transparencën e plotë të financimit të partive politike. Prej kohës kur këto ligje u futën në fuqi, nuk ka pasur ndonjë trajtim real dhe masa të ndërmarra me gjoka që do të merreshin për konsideratë qoftë

për shkelje në mungesë të raportimit të financave, qoftë në mungesën e vërtetimit të dëshmive për prejardhjen e donacioneve. Në të njëjtën periudhë, nuk munguan kritikën e mëdha nga ana e shoqërisë civile për lidhjen e vazhdueshme në mes të donatorëve të partive (sidomos atyre në pushtet) me përfitimet e tenderëve publikë. Si rrjedhojë, Kuvendi i Kosovës në vitin 2013, nxori një ligj të ri, përkatësisht Ligjin nr. 04/L-212 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike të Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-058.¹³ Ndryshimet thelbësore që iu shtuan ligjit bazik në këtë rast i adresonin pikëpamjet e përgjithshme dhe nevojën për transparencë më të madhe. Kështu ligji i ri sanksionoi shfrytëzimin e vetëm një llogarie bankare nga partitë politike në të cilën do të mund të evidentoheshin më lehtë të gjitha transaksionet e bëra dhe donacionet e pranuar. Po ashtu, ligji i ri ndaloi financimin e partive nga ndërmarrjet private të cilat janë në marrëdhënie kontraktuale në ofrimin e mallrave dhe shërbimeve me institucionet e Republikës së Kosovës si dhe tre vite pas përfundimit të marrëdhënies kontraktuale.¹⁴ U sanksionua edhe u ndalua çdo financim për kandidatë të partive politike pa kaluar nëpër procedurat e përcaktuara përmes partisë politike.¹⁵ Ndryshimi më i spikatur ishte edhe në raport me kontrollin financiar ku përmes nenit 19, Ligji parashihet auditimin e financave të partive politike nga një trup i përzgjedhur nga Kuvendi i Kosovës. Pas procedurës së auditimit, KQZ-ja obligohej që raportet finale të auditimit bashkë me raportet vjetore financiare të partive politike t'i dorëzonte në Agjencinë Kundër Korrupsionit për ekzaminim të mëtutjeshëm.

Me këto ndryshime, përgjithësisht u hodhën bazat që do të mund të shërbenin për disiplinimin e partive politike në kuptim të bërjes transparente të financimit të tyre. Megjithatë, që nga viti 2013 kur u miratuan ndryshimet e fundit, përjashtuar një tentativë të dështuar nga ana e Kuvendit për të përzgjedhur auditorë që do të bënin auditimin e raporteve financiare, deri më sot financat e partive politike pas hyrjes në fuqi të Ligjit bazik dhe dy ligjeve plotësuese nuk janë audituar asnjëherë.

10 Ligji nr.04/L-58 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2795>

11 Neni 5: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2795>

12 Neni 7, pika 3: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2795>

13 <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20ndryshimin%20e%20ligjit%20per%20financimin%20e%20subj%20politike.pdf> ;

14 Neni 6 i Ligjit nr. 04/L-212 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike të Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-058; <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20ndryshimin%20e%20ligjit%20per%20financimin%20e%20subj%20politike.pdf>;

15 Neni 6, pika 4: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20ndryshimin%20e%20ligjit%20per%20financimin%20e%20subj%20politike.pdf>;

Ky problem është theksuar edhe në Raportet e BE-së për Kosovën,¹⁶ dhe është shtruar nevoja imediate që të ndërmerren hapa në zbatimin e dispozitave ligjore përkittazi me auditimin e financave të partive politike.

Thënë në përgjithësi, në Kosovë ekziston një bazë ligjore që do të mund të konsolidonte shumë probleme që e karakterizojnë financimin e partive politike, por zbatimi i tyre në praktikë qoftë si procedurë qoftë si përmbajtje ka munguar dhe vazhdon të mungojë edhe sot, për çka është vështirë të vihen në pah përparësitë dhe të metat e modelit kosovar të financimit të partive politike.

3.1 Natyra e Burimeve të Financimit

Pavarësisht nëse duket e drejtë për t'u cilësuar apo jo, teorisht ekziston një bindje qytetare se partitë politike kanë financues të ndryshëm nga sfera private, që i ndërlidhin interesat e tyre ekonomike me ndikimin që kanë partitë politike, me theks të veçantë ato në pushtet. Sipas logjikës së thjeshtë, partitë politike që menaxhojnë me dikastere qeveritare ka gjasa që të shpërblejnë financuesit e tyre nga sfera e biznesit me kontrata publike. Një ndërmarrësi e tillë ndikon në shumë mënyra përfshirë mungesën e trajtimit të barabartë të bizneseve, mungesën e prirjes drejt ofrimit cilësor të mallrave dhe shërbimeve, shtypjen e konkurrencës dhe dhënien e kontratave mbi logjikën e shpërblimit më shumë sesa performancës dhe kompetencës.

Kjo perspektivë që në Kosovë haset në diskutime ditore, ndikon edhe në krijimin e një klime varësie të bizneseve dhe ndërmarrësve ndaj politikës si dhe disfavorizon ndërmarrësit e rinj që nuk kanë lidhje politike. Debati merr kahje të rëndësishme kur kemi parasysh edhe faktin se institucionet publike janë punëdhënësit më të mëdhenj jo vetëm për individë por edhe për biznese. Qëllimi final i iniciativës për transparencë të financimit të partive politike është pikërisht i lidhur me evitimin e një situatë të tillë. Për këtë, është e nevojshme që burimet e financimit të partive të mbahen transparente dhe që donatorët e partive të mos e shohin mbështetjen e partive si alternativë të ngushtë të përfitimit. Por sa ka gatishmëri të tillë nga bizneset për të qenë të

lira nga politika dhe sa ka gatishmëri nga politika për të qenë e pavarur nga interesat e biznesit gjatë ushtrimit të mandateve politike në nivel institucionesh? A janë lidhjet e tilla ekzistuese dhe mbi çfarë motivesh bizneset dhe individët financojnë partitë politike? Për të kuptuar këtë diskurs, është e nevojshme që të analizohen burimet e përgjithshme të financimit të partive politike.

Gjatë fazës së shqyrtimeve dhe ndërtimit të logjikës argumentuese të kësaj analize, janë marrë në konsideratë edhe pikëpamjet e përgjithshme të partive politike lidhur me natyrën e përgjithshme të financimit të tyre me dispozitat ligjore në fuqi dhe me burimet financiare të tyre. Në këtë rrjedhë, më poshtë janë dhënë shkurtime shpjegimet dhe qëndrimet e subjekteve politike të intervistuar për çështjen e financimit.

AAK

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës sipas zyrarit financiar të saj Valon Tolajt,¹⁷ burim kryesor të financimit ka buxhetin publik i cili ndahet sipas ligjit dhe formulës së përcaktuar krahas fuqisë politike të saj të përkthyer në ulëset në Kuvend si dhe në normat e përcaktuara të financimit për fushatat zgjedhore. Sipas Tolajt, AAK financohet edhe nga donatorët e saj të jashtëm të cilët kryesisht figurojnë të jenë edhe anëtarë të partisë,¹⁸ por nuk ka të identifikuar ndonjë donator specifik qoftë si entitet juridik apo fizik dhe se kjo parti nuk ka financues të rregullt. Tolaj thekson se raportimet financiare periodike dhe vjetore nuk kanë qenë dhe nuk janë problem për AAK-në dhe se ekziston gatishmëria edhe për t'i bërë publike të gjitha burimet e financimit gjë që deri më tani nuk është bërë për shkaqe teknike.

LDK

Lidhja Demokratike e Kosovës sipas zyrarit të saj financiar, Lutfi Zharkut,¹⁹ ngjashëm si AAK-ja, burim kryesor të financimit e ka buxhetin publik të ndarë sipas formulës së përcaktuar me ligj. Sipas Zharkut, buxheti i ndarë për LDK-në është përgjithësisht i mjaftueshëm për të siguruar funksionimin e rregullt të partisë prandaj kjo parti

16 Kosovo Progress Report 2016: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf;

17 Intervistë e zhvilluar me datë 18 Tetor 2016 nga ora 11:00;

18 Shih raportet e auditimit 2010; http://kqz-ks.org/Uploads/Documents/Raporti_i_auditimit_te_fushates_per_vitin_2010_spvokoaxuk.pdf;

19 Intervistë e zhvilluar me datë 19 Tetor 2016, nga ora 10:00;

nuk është se ka ndonjë nevojë për të qenë e varur nga donacionet e jashtme pavarësisht faktit se edhe kjo ka donatorë që kontribuojnë në të ardhurat e partisë. LDK-ja sipas Zharkut është përgjithësisht rigorozë në aspektin e menaxhimit të financave të partisë dhe se bilancet e saj janë pozitive. Edhe për LDK-në çështja e transparencës së burimeve të financimit nuk paraqet ndonjë problem dhe se në të ardhmen parashihet publikimi i listës së donatorëve të rregullt të kësaj partie.

PKD

Partia Demokratike e Kosovës, duke iu referuar Sekretarit të Përgjithshëm të saj, Basri Musmurati²⁰ po ashtu burim kryesor të financimit e ka fondin publik që ndahet për parti të politike. PDK-ja ka komoditet për të qenë partia me shumën më të madhe të mjeteve që ndahen nga fondi dhe se përgjithësisht kjo shumë është e mjaftueshme për të organizuar funksionimin e rregullt të partisë. Sipas Musmuratit, PDK-ja ndonjëse në të kaluarën ka pasur financues edhe nga sektori i biznesit dhe individë të ndryshëm, çdo ditë e më shumë është larg aplikimit të kësaj mënyrë të financimit. Gjithmonë sipas Musmuratit, Partia Demokratike e Kosovës së paku në tre vitet e fundit nuk ka qenë adresë e financimit nga bizneset, qofshin ato përfituese ose jo të tenderëve publikë. Musmurati konstaton se PDK-ja ka qenë dhe është e rregullt në raportimet vjetore të financave pranë KQZ-së si dhe nuk nguron të mbajë qëndrim se një transparencë e plotë e financuesve të partisë nuk paraqet asnjë problem për këtë subjekt.

LVV

Lëvizja Vetëvendosje! ndryshe nga parti të tjera burimet e financimit të saj i ka bërë transparente përmes publikimit të raporteve financiare vjetore, në faqen elektronike të saj. Në këto raporte, përveç të hyrave nga buxheti janë të paraqitura edhe donacionet e mbështetësve dhe anëtarëve të saj. Kjo praktikë sipas Ilir Cacajt²¹ do të duhej të ndiqej nga të gjitha parti të tjera në mënyrë që të definohen financuesit si një mënyrë që qytetarët të kenë një pasqyrë mbi interesat e mundshme dhe ndërlihdjet me sferat e përfitimt.

Marrë në përgjithësi, nga të kuptuarit e intervistave figuron që parti të politike në Kosovë, burim themelor të financimit kanë buxhetin publik. Natyrisht se ky është versioni zyrtar i tyre dhe se tendencat për t'u paraqitur të gatshëm në bërjen transparente të financuesve të tyre janë pjesë e çdo diskutimi. Partitë në përgjithësi e sidomos ato që bartin pushtetin institucional mohojnë kategorikisht lidhjet e mundshme të financuesve të tyre me shpërblimet që marrin ata nga parti të politike që bartin pushtetin. Ato po ashtu kanë qëndrime të prera sa i përket financimit të kandidatëve të përveçëm jashtë vijës zyrtare të partive. Sipas kësaj logjike, parti të politike funksionojnë mirfillazi konform ligjit dhe se shpenzimet e përgjithshme dhe ato gjatë fushatave zgjedhore nuk tejkalojnë shumën e mjeteve financiare të dedikuara nga fondi publik.

I një mendimi të njëjtë nuk është analisti Ibrahim Rexhepi²² nga Qendra për Hulumtime Strategjike dhe Sociale – STRAS. Sipas Rexhepit, pavarësisht linjës së qëndrimeve zyrtare të partive, në Kosovë dukuria e ndërlihdjes mes partive dhe financuesve të tyre tejkalon dukshëm admirimin vetëm mbi baza të preferencave politike apo besimit në to. Ka një lidhje të pashkëputur mes biznesit dhe politikës e cila për disa biznese ka qenë shumë fitimprurëse. Madje, sipas Rexhepit, klima e krijuar është aq e fortë, sa që çdo kush që pretendon të fillojë një biznes, para se të kualifikojë natyrën e biznesit që do të ushtrojë, do të analizojë fillimisht lidhjet e mundshme politike që i ka në dispozicion në mënyrë që të sigurojë mbështetjen e duhur për të përfituar tenderë publikë. Ka raste kur bizneset kanë ndërruar edhe llojin e veprimtarisë vetëm e vetëm për t'iu përshtatur natyrës së punëve që binin në kuadër të ministrive të caktuara në të cilat bizneset kishin qasje klienteliste. Sipas Rexhepit, ka raste kur financimi i partive politike dhe kandidatëve, me theks të veçantë gjatë fushatave zgjedhore sipas vlerës së tregut të materialeve propaganduese, aktiviteteve në terren dhe reklamave televizive vetëm në nivel kandidati tejkalon buxhetin e ndarë nga fondi publik për tërë partinë, prandaj është e pamundur fshehja e të hyrave dhe shpenzimeve nën emrin e buxhetit publik.

Problemi që del në pah nga këto dy mendësi perceptivë rreth burimeve të financimit të partive politike bëhet akoma më i madh kur nuk ekziston një traditë institucionale e ndëshkimit, hetimit dhe zbrërthimit të lidhjes mes donatorëve dhe partive politike. KQZ-ja si një mekanizëm i referuar për zbatimin e Ligjit për Financat e Subjekteve

20 Intervistë e zhvilluar me datë 25 Tetor 2016, nga ora 11:00;

21 Intervistë e zhvilluar me datë 21 Tetor, 2016 nga ora 15:00;

22 Intervistë e zhvilluar me datë 26 Tetor 2016, nga ora 12:00;

Politike, nga të gjithë shtyllat funksionale të saj, këtë de-tyrë e ushtron më zbehtë dhe thujse vetëm formalisht.

Miradie Mavriqi nga KQZ-ja,²³ përkundër dëshirës për të pasur një rol më efikas, pranon se Zyra për Regjistrimin e Partive Politike në kuadër të së cilës bien edhe çështjet e raportimit të financave, nuk ka kompetenca përmbajtjesore përveçse respektimin e afateve kohore të raportimit, mbledhjen dhe ruajtjen e materialeve të dorëzuara nga partitë politike si dhe lëshimin e gjobave në rast të shkeljes së dispozitave ligjore që lidhen me afatet kohore. Sipas Mavriqit, situata ekzistuese është mjaft komplekse dhe se brenda zyrës nuk ka një mandat të qartë se deri ku shtrihet kompetencat e KQZ-së për të ngritur çështje që lidhen me financimin e partive politike apo burimeve të jashtme të financimit të tyre. KQZ-ja mban përgjegjësi vetëm që pas dorëzimit të raporteve financiare tre mujore, t'u alokojë partive politike mjetet e ndara nga fondi publik. Për më tepër, natyra e raporteve financiare që dorëzojnë partitë politike përgjithësisht lidhet vetëm me shpenzimin e mjeteve por jo edhe me të hyrat nga donacionet.

Duke pasur parasysh mënyrën se si janë ndërtuar raportet e përgjithshme institucionale për zbatimin e ligjit në fjalë dhe kompetencat që rregullojnë veprimtarinë e KQZ-së në njërin anë, si dhe realitetin ekzistues dhe bindjet e përgjithshme mbi ndikimin e madh që ka pushteti i parasë në pushtetin politik në anën tjetër, bëhet e qartë se mungon një adresë e mirëfilltë institucionale në mënyrë që ky ligj të marrë kuptim të plotë. Se a mund të bie zbatimimi i tij në kuadër të kompetencave që ushtron Agjencia Kundër Korrupsionit, Prokuroria dhe Policia apo ndonjë mekanizëm i ngjashëm i zbatimit të ligjit, kjo do të duhej të definohej me urgjencë, përdërisa lidhja e politikës me parandë duket se dikton në masë të madhe jo vetëm zhvillimet politike por edhe ato të karakterit ekonomik e social.

Për më tepër, ajo që do të duhej të vinte si rezultat i zbatimit të ligjit nuk është ndalimi ose lejimi i financimit të partive nga burimet e jashtme të financimit por se të njëjtat do të duhej të bëheshin transparente në mënyrë që të sigurohej një lidhje logjike mbi atë se si përkthehen këto financime në zbatim të pushtetit politik dhe nëse të njëjtat janë duke ndikuar negativisht për zhvillimin e përgjithshëm të demokracisë dhe zhvillimin e konkurrencës së lirë.

Agjencia Kundër Korrupsionit deri me tani ka pasur rol pasiv në ndërmarrjen e ndonjë hetimi administrativ apo përmbajtjesor që do të mund të hidhte dritë mbi këtë realitet ekzistues. Megjithatë, sipas drejtorit të AKK-së, Shaip Havollit,²⁴ kjo çështje është nga më të ngutshmet për t'u shtruar dhe se AKK-ja e sheh si të nevojshme përfshirjen në monitorimin e lidhjes së parasë me politikën. Natyrisht se për një ndërmarrësi të tillë, është i nevojshëm një sqarim mandatesh dhe kompetencash për çfarë Havolli siguron se AKK-ja është e gatshme të marrë përsipër që në kuadër të kompetencave të saj, të përfshihet edhe zbatimimi i plotë i Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike.

Përfshirja e mundshme e AKK-së në monitorimin e zbatimit të ligjit në fjalë ka relevancë dhe do të duhej të merrej në konsideratë nga akterët institucionalë. Kjo për faktin se pa një mekanizëm që ka kompetenca dhe autorizime për të ndërmarrë hetime të llojit **shkak-pasojë** të lidhjes mes financuesve dhe partive politike, ligji nuk do të sillte asnjë dobi konkrete.

Mbi këtë logjikë, edhe vetë auditimi i partive politike do të merrte kuptim më të denjë. Në të kundërtën, pavarësisht faktit se kalimi i kompetencave për zgjedhjen e auditorëve në Kuvendin e Kosovës, aty ku janë të përfaqësuara partitë politike paraqet një regres në ushtrimin pa ndikim të këtij mandati, edhe një auditim mbi bazën aktuale nuk do të ishte produktiv dhe me impakt real.

Kryetari i Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike Faton Topalli,²⁵ mbështet këtë pikëpamje si mënyra më e mirë për të pasur një efekt të ligjit në praktikë. Sipas Topallit, çështja e auditimit të financave të partive politike përveç një iniciative të ndërmarrë në vitin 2013, deri në ditën kur referohemi, nuk është aktualizuar dhe se për aktualizimin e saj, ky i fundit ka kërkuar raport nga organet administrative të Kuvendit. Megjithatë, sipas konstatimit të Topallit, edhe në rast se përzgjidhen auditorët dhe bëhet auditimi i financave të partive politike qoftë për vitin aktual qoftë në mënyrë retroaktive nga viti 2013, prapë se prapë vetëm një auditim që konstaton raportet financiare është jo relevant për të ndikuar në agjendën e parandalimit të aktiviteteve të dyshimta financiare të partive politike.

²³ Intervistë e zhvilluar me datë 26 Tetor 2016, nga ora 10:00;

²⁴ Intervistë e zhvilluar me datë 11 Nëntor 2016, nga ora 10:00;

²⁵ Intervistë e zhvilluar me datë 11 Nëntor 2016, nga ora 15:00;

Nga përmbajtja e shtruar më lartë si rrumbullakësim i qëndrimeve zyrtare të partive politike dhe akterëve të tjerë të konsultuar me këtë rast, del në pah një diskurs që reflekton dy kuptime themelore: atë të partive politike që përgjithësisht eviton pranimin e fuqisë së parasë dhe atë të akterëve të tjerë institucionalë e të shoqërisë civile që pohojnë një ndikim të tillë. Për të ballafaquar këtë realitet, kapitulli i mëposhtëm hedhë dritë mbi relacionet që janë krijuar në mes të sferës së biznesit dhe politikës dhe mënyrës së si këto relacione janë përkthyer përmes shkëmbimit të financimit me interesa ekonomike.

3.2 Shkalla e transparencës dhe ndërlidhjet e bizneseve me partitë politike

Përderisa demokracia sot, paraqet formën më universale të qeverisjes në përmasa globale, zgjedhjet e rregullta në mes të partive politike konkurruese janë metoda dominuese e ardhjes në pushtet.²⁶ Në këtë proces, partitë politike dhe kandidatët kanë nevojë për të pasur qasje në mjete financiare në mënyrë që të arrijnë qasjen tek elektorati për të shpjeguar pikëpamjet dhe politikat e tyre. Mbi këto parametra, financimi politik ka tipare pozitive sepse u mundëson kandidatëve dhe partive një konkurrencë më të barabartë dhe krijim të besimit të mbështetësve të tyre.

Megjithatë, në realitet, sistemet politike mund të karakterizohen si sisteme që veprojnë jashtë idealeve të përgjithshme demokratike. Një nga faktorët kyç që ndalon sistemet politike të sillen me norma tërësisht demokratike është ndikimi i parasë. Grupet e ndryshme të interesit, përmes fuqisë dhe ndikimit të parasë mund të “blejnë” politikanë në mënyrë që të influencojnë marrjen ose jo të vendimeve që janë në favor të tyre.

Për këtë arsye bërja transparente e burimeve të financimit të partive politike është temë shumë e rëndësishme brenda ciklit të përgjithshëm të demokracisë, dhe është temë që duhet të adresohet në Republikën e Kosovës, jo vetëm në aspektin institucional por edhe në atë të shoqërisë si bashkësi politike.

Në tetor të vitit 2015, hulumtuesit e gazetës Preportr kanë publikuar një hulumtim të gjerë mbi lidhjet e financuesve të partive politike me përfitimet e tenderëve publikë. Rezultatet e hulumtimit nën prizmin e analizës japin për të kuptuar se nga logjika e një biznesi dhe klima e krijuar, financimi i partive politike paraqet një nga mënyrat më të shpejta për kthim të shumëfishtë të investimeve.²⁷

Sipas hulumtimit, nga periudha gusht 2007 deri në maj 2014, financuesit e partive politike qoftë si biznese apo pronarë të bizneseve kanë përfituar rreth 220 milionë euro tenderë publikë.²⁸ Nga këta përfitues, marrë në total më së shumti janë shpërblyer financuesit e Partisë Demokratike të Kosovës dhe Lëvizjes Vetëvendosje!, ndërsa relativisht pak edhe ata të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Aleancës Kosova e Re.²⁹ Hulumtimi jep të dhëna të detajuara për secilën kontratë dhe shumën e saj që kanë përfituar financuesit e partive politike. Në këtë vijë, është me rendësi të analizohet ky trend sidomos për dy partitë që përbënin qeverinë në periudhën 2009-2012.

Nga të dhënat e nxjerra figuron që Partia Demokratike e Kosovës gjatë viteve 2009-2012 ka pranuar donacione nga 52 subjekte biznesore apo pronarë të bizneseve, në vlerë prej 151,007 Euro.³⁰ Të njëjtat subjekte nga institucionet publike kanë përfituar gjithsej 325 tenderë, në vlerë të përgjithshme prej 162,517,080 Euro.³¹

Lidhja Demokratike e Kosovës gjatë periudhës 2009-2012 ka pranuar burime në vlerë prej 10,400 eurosh nga 7 subjekte juridike, të cilat gjatë kësaj periudhë kanë përfituar 13 tenderë në vlerë prej 419,631 euro.

26 IDEA, “Funding of Political Parties and Election Campaigns: A Handbook on Political Finance” 2014, fq. 1; <http://www.idea.int/sites/default/files/publications/funding-of-political-parties-and-election-campaigns.pdf>;

27 Besa Kalaja, Qëndrim Bunjaku, Kosovare Lalinovci, Leonidë Molliqaj, “Politika e Parasë” Preportr nr. 14, Tetor 2015; <http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/Politika-e-parase-71>;

28 Po aty;

29 Po aty;

30 Çohu Open Data <http://opendata.cohu.org/sq/rretezimi-i-lidhjeve-te-biznesit-me-politiken>;

31 Po aty;

TAB1 Donacionet në të holla dhe kontributet në natyrë në mall dhe shërbime që kanë pranuar subjektet politike gjatë viteve 2009-2012: të kategorizuara sipas personave fizikë dhe juridikë



Tabela 1.³² Donacionet në të holla dhe kontributet në natyrë në mall dhe shërbime që kanë pranuar subjektet politike gjatë viteve 2009-2012: të kategorizuara sipas personave fizikë dhe juridikë;

Duke u nisur nga këto konstatime të hulumtimit në fjalë, mund të vërehet se në Kosovë ekziston një fenomen i tillë i njohur si “pushtet i parasë” dhe se kjo logjikë ndikon në

shumë mënyra në të drejtën për ushtrimin e lirisë politike, ekonomike e sociale të qytetarëve dhe komunitetit të biznesit. Për të pasur më të qartë këtë lidhje, më poshtë janë nxjerrë disa nga të dhënat e raportit të Preportr, të cilit i jemi referuar për relevancë me temën e trajtuar në këtë analizë. Referimi ndaj këtyre të dhënave për të nxjerrë një kuptim të kësaj natyre ka qenë domosdoshmëri për shkak të mungesës së hulumtimeve më aktuale që do mund të merreshin për bazë.

32 Çohu Open Data: <http://opendata.cohu.org/sq/rjetezimi-i-lidhjeve-te-biznesit-me-politiken>;


PDK Mënyra e financimit të PDK-së³³

Në shikimin e përgjithshëm PDK-ja ka pasur raporte pothuajse klienteliste me donatorët e saj. Gjatë shtatë viteve në pushtet, dikasterët e udhëhequra nga PDK-ja kanë dhënë tenderë për financuesit e saj në vlerë prej qindra miliona eurosh.

Në total, hulumtimi i Preportr ka mundur të identifikojë që 52 subjekte që kanë financuar PDK-në, si persona fizikë ose si persona juridikë, kanë marrë nga institucionet publike 325 tenderë, vlera e të cilëve arrin 162,517,080 euro.

Të dhënat për kompanitë që kanë marrë tenderë vijnë prej dy ministrive (Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Transportit, tash Ministria e Infrastrukturës) që për periudhën 2007-2014, kanë pasur buxhet më të madh se institucionet tjera.

Të hyrat e PDK-së (2009-2012)



Burimi: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), raportet financiare dhe auditimet

33 Preportr 14 "Politika e parasë", Tetor 2015; http://preportr.cohu.org/repository/docs/1509-Preportr14SHQIP_895529_359373.pdf


LVV Mënyra e financimit të VV-së³⁴

Edhe pse e regjistruar shumë vonë si subjekt politik (më 2010), Lëvizja Vetëvendosje!, ndryshe prej LDK-së dhe AAK-së, deklaron shumë financues, disa prej të cilëve prej disa vitesh janë financues të PDK-së. Hulumtimi tregon se financuesit e Vetëvendosjes! Po ashtu bëjnë pjesë në listën e bizneseve që janë shpërblyer shumë më shumë se sa financuesit e tri partive tjera që kanë qenë në pushtet në nivelin qendror si LDK-ja, AAK-ja dhe AKR-ja.

Financuesit e LVV-së kanë marrë 42 tenderë nga MASHT-i, MTPT-ja dhe MI-ja në vlerë 58,493,257 euro. Ndërsa bizneset që kanë financuar LVV-në, kanë marrë 17 tenderë tjerë nga institucionet tjera në vlerë 1,208,302 euro. Gjatë tri viteve (2010-2012), LVV-ja ka marrë nga bizneset ose pronarë biznesesh 161,618 euro në formë donacioni.

Për dallim nga të gjitha partitë që janë pjesë e këtij hulumtimi, LVV-ja është e vetmja e cila ka bërë publike raportet financiare vjetore dhe ato të shpenzimeve gjatë zgjedhjeve që nga koha kur ajo është pjesë e institucioneve. Këtu hyjnë edhe raportet e viteve 2013-2014, por këto raporte nuk janë marrë në konsideratë për shkak se ato janë ende të paaudituar nga një auditor i pavarur.

Të hyrat e LVV-së (2009-2012)



Burimi: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), raportet financiare dhe auditimet

34 Preportr 14 "Politika e parasë", Tetor 2015; http://preportr.cohu.org/repository/docs/1509-Preportr14SHQIP_895529_359373.pdf

LDK Mënyra e financimit të LDK-së³⁵

Lidhja Demokratike e Kosovës, në bazë të pasqyrave financiare që janë bërë publike nga KQZ-ja, gjatë viteve 2009-2012, ka marrë pak donacione dhe ka dhënë pak tenderë, edhe pse ishte në pushtet si në nivelin qendror deri më 2010 (e rikthyer në krye të qeverisë pas zgjedhjeve të fundit parlamentare të 2014), por edhe në disa komuna në nivelin lokal, madje në Prishtinë ka udhëhequr që prej pasluftës deri në vitin 2013.


Në fushatën parazgjedhore të vitit 2010, për dallim nga ajo e vitit 2009, Lidhja Demokratike e Kosovës që është partia e dytë në vend ka paraqitur pak të hyra nga donatorë të jashtëm.

Ajo ka deklaruar shumë pak donatorë edhe gjatë viteve 2011 dhe 2012. Në raportin e auditimit të financave të partive të publikuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), Preportr ka gjetur se një pjesë e tyre janë biznesmenë.

Sidoqoftë, sipas hulumtimit del se pjesa më e madhe e tyre nuk kanë marrë tenderë publikë, por ka edhe nga ata që janë favorizuar për më shumë se një dekadë, siç është rasti i një kompanie marketingu³⁶ e cila për shumë vite ka monopolin me hapësirat reklamuese në kryeqytet.

Të dhënat tregojnë se shtatë kompani që kanë financuar LDK-në, kanë fituar 13 tenderë në institucione publike. Vlera e këtyre tenderëve është 419,631 euro.

Të hyrat e LDK-së (2009-2012)



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), raportet financiare dhe auditimet

35 Preportr 14 "Politika e parasë", Tetor 2015; http://preportr.cohu.org/repository/docs/1509-Preportr14SHQIP_895529_359373.pdf

36 Besnik Boletini, "Monopoli komunal në reklama", 17 Janar 2012; <http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/Monopoli-komunal-ne-reklama-156> dhe Besnik Boletini, Visar Duriqi, "AMM – Absolut Mustafa Monopol", 13 Qershor 2012; <http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/AMM-Absolut-Mustafa-Monopol-159>




Mënyra e financimit të AAK-së³⁷

Pesë kompani që kanë financuar AAK-në kanë fituar 26 tenderë në institucione publike. Vlera e këtyre tenderëve është 9,767,240 euro.

Natyre pak a shumë të njëjtë të financimit me LDK-në ka edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Gjatë fushatave, këtë parti e kanë mbështetur me mjete anëtarë të partisë, disa prej tyre biznesmenë.

Gjatë 4 viteve AAK ka pranuar si donacion nga bizneset ose pronarët e tyre 147,200 euro në formë donacioni.

Të hyrat e AAK-së (2009-2012)



Burimi: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), raportet financiare dhe auditimet

37 Preportr 14 "Politika e parasë", Tetor 2015; http://preportr.cohu.org/repository/docs/1509-Preportr14SHQIP_895529_359373.pdf





Mënyra e financimit të AKR-së³⁸

Aleanca Kosova e Re (AKR), ka marrë shumë donacione, duke tejkaluar në vitin 2010 edhe partinë më të madhe në vend, PDK-në. Në këtë vit, AKR ka marrë si donacione 425,451.43 euro; PDK kishte marrë 351,734.73 euro.


Financimi i AKR-së është më specifik. Atë e kanë mbështetur familjarë të biznesmenit dhe udhëheqësit të partisë- kjo në bazë të mbiemrit. Partinë e tij e kanë mbështetur edhe njerëz nga vendi i lindjes së tij.

Hulumtimi ka nxjerrë disa statistika nga raportet e pasqyrave financiare që kjo parti i ka dërguar në KQZ.

Në 2010, nga 195 donatorët që e kanë mbështetur AKR-në, 31 prej tyre e kanë mbiemrin Pacolli, 6 Makolli, 2 Vitia dhe 2 të tjerë Gërbeshi. Me 2011, nga 41 donatorët, 4 janë me mbiemrin Pacolli, 2 Makolli. Në këtë vit, AKR-ja ka marrë vërejtje nga auditori që ka pranuar mjete nga jashtë, veprim ky që bie në kundërshtim me ligjin³⁹.

Donacionet për këtë parti kanë ardhur prej nga jashtë dhe në shuma që nuk lejohen me ligj. Kjo ka bërë që AKR-ja në raportet e auditimit të KQZ-së të dalë partia më me së shumti shkelje ligji. Financuesit e AKR-së nuk kanë marrë shumë tenderë në institucione publike. Gjashtë kompani që kanë financuar AKR-në kanë fituar 42 tenderë nga institucionet publike. Vlera e këtyre tenderëve është 3,089,817 euro. Gjatë katër viteve, AKR-ja ka marrë nga subjektet juridike dhe fizike 128,328 euro në formë donacioni.

Të hyrat e AKR-së (2009-2012)



Burimi: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), raportet financiare dhe auditimet

38 Preportr 14 "Politika e parasë", Tetor 2015; http://preportr.cohu.org/repository/docs/1509-Preportr14SHQIP_895529_359373.pdf

39 Neni 11 Ndalimi i ndihmave financiare 1. Ndalohet ndihma financiare dhe materiale nga: 1.1. institucionet qeveritare dhe joqeveritare të huaja, si dhe personat fizikë dhe juridik të huaj;

Nëse merren për bazë të dhënat e siguruar nga Pre-portr, atëherë mund të nxirret në përfundim se lidhja në mes partive politike dhe financuesve të tyre në Kosovë paraqitet në së paku dy forma:

- a) **Klientelizmi.** Motivet prapa se cilave një financues shpreh gatishmëri për të dhuruar mjete financiare tek një parti politike në Kosovë bazohen në raportin “jep dhe merr”. Sipas këtij raporti, çdo donator do ta mbështeste një parti politike nëse e njëjta i siguron garanci për mbështetje përmes dhënies së kontratave publike;
- b) **Blerja.** Një mënyrë se si mund të kuptohet ndikimi i parasë në politikë në rastin e Kosovës është edhe shpjegimi brenda nocionit të blerjes. Me këtë rast nuk bëhet fjalë për blerje votash, por për blerje politikanësh. Financues të caktuar japin donacione për partitë politike dhe për politikanët e përveçëm në mënyrë që të njëjtit të avancojnë agjenda legjislativë, fiskale e monetare që janë brenda fushës së interesit të financuesve;

Këto dy mënyra të të kuptuarit të ndikimit të pushtetit të parasë në politikë, në rastin e Kosovës nuk kanë kaluar pa qenë pjesë e diskutimeve nga shoqëria civile, mediat dhe opinioni i gjerë. Për një kohë të gjatë analistë, gazetarë dhe pjesëtarë të shoqërisë civile kanë debatuar rreth relacioneve të kompanive të mëdha siç janë Korporata Devolli, ETC, City Park etj. Për më tepër, disa nga pronarët e kompanive të lartcekura përveçse kanë qenë financues të rregullt të subjekteve politike, së fundmi janë bërë pjesë e politikës dhe institucioneve shtetërore me ndikim.

Se a ekziston një balancë në mes përfaqësimit të interesave qytetare dhe interesave biznesore nga “kapitalistët kosovarë” që bartin mandate politike është një nga çështjet bosht që duhet të bie në temën e përgjithshme të shtruar në këtë analizë. ***(Një punë plotësuese që do të ishte e mirëseardhur dhe që do të hidhte dritë mbi relacionin në mes të financimit të politikës dhe përkthimit të kësaj mbështetje në ushtrimin e pushtetit institucional nga ana e partive në pushtet do të ishte edhe analizimi i relacioneve të deputetëve dhe partive që sponsorizojnë ligje me burimet e financimit të tyre).***

Së fundmi, e tërë logjika e transparencës së financimit të partive politike ka për qëllim identifikimin e “Raison D’etre”⁴⁰ më shumë sesa vetë idenë se sa para grumbullojnë partitë politike nga burimet e ndryshme të financimit.

Për më tepër, në botën demokratike ekzistojnë modele të ndryshme të financimit, duke filluar nga ato që lejojnë financim të hapur, ato që kufizojnë financimin dhe ato që financimin e partive e bartin si kosto publike. Në Kosovë nuk është se kontestohet ideja që partitë politike të kenë mundësi të ngrisin fonde nga burimet e tyre. Por të gjitha modelet e lartpërmendura, në qendër të vëmendjes kanë transparencën e financimit, gjë që do të duhej të ishte preokupimi primar edhe në sferën institucionale të Republikës së Kosovës.

Se a janë përcaktuar partitë politike për një model të cilin e kanë etabluar me ligj, kjo mbetet e kontestuar për shkak se ligji në kohëzgjatjen e ekzistimit të tij, ka qenë i paefektshëm. Se a ka nevojë për përcaktimin fillimisht të një modeli e pastaj etablimin e tij me masa ligjore, kjo po që është e një nevojë emergjente. Pjesa vijuese e punimit flet për tri modele të financimit të partive politike dhe karakteristikat themelore të tyre, të cilat do të mund të merreshin në konsideratë qoftë si modele që mund të adoptohen apo edhe si modele që duhet të evitohen.

40 Raison D’Etre është koncept që nënkupton arsyet themelore të ekzistencës së një procesi, fenomeni apo mekanizmi. Pyetja themelore që përcillet përmes përdorimit të këtij koncepti, është “përse ekziston dhe në dobi të kujt ekziston një fenomen?”.

4. TRI MODELE TË FINANCIMIT TË PARTIVE POLITIKE: FRANCA, SHBA DHE NORVEGJIA

Në trajtimet e mësipërme u shtrua për diskurs realiteti ekzistues në Kosovë në raport me çështjen e financimit të partive politike. Përderisa pjesa e mësipërme e shtruar në këtë analizë, na ofron një të kuptuar themelor mbi bazën ligjore, problemet e implementimit të ligjit, deficitet me transparencën e financuesve të partive politike, probleme këto që e vështirësojnë kuptimin nëse modeli i financimit të partive politike në Kosovë është model i duhur, në shembuj të shumtë nga demokracitë perëndimore ka alternativa se si përcaktimi për një model do të mundësonte edhe bërjen e ligjeve adekuate si dhe zbatimin e tyre. Në fakt, pjesa më e madhe e vendeve ku mekanizmat ligjorë që rregullojnë financimin e partive

politike funksionojnë mirëfilli, prejardhjen e kanë duke pasuar realitete të domosdoshme. Pra, fillimisht është përcaktuar modeli, bazuar kryesisht në një tipologji të tillë nëse financimi do të jetë i kufizuar apo i pakufizuar, për t'u pasuar pastaj me nxjerrjen e ligjeve që deshifronin në praktikë modelin për të cilin ishin përcaktuar këto vende. Karakteristikë tjetër e kësaj tipologjie, është edhe fakti se zakonisht hartimit të legjisllacionit në këtë fushë i kanë paraprirë debate të mëdha pak a shumë të ngjashme me këto që hasim si të nevojshme për t'u shtruar edhe në Kosovë. Megjithëse përgjithësisht pluralizmi politik asocohet edhe me pluralizëm në modelet dhe mendësitë e financimit të partive politike, porë nga perspektiva globale



dhe praktika, ekzistojnë tre modele themelore që në vija të trasha gjinden të veçuara apo të kombinuara në secilin legjislacion bashkëkohor që rregullon këtë fushë.

Modeli i parë në këtë klasifikim, është **modeli i financimit të kufizuar** i cili nënkupton se partitë politike mund të financohen nga buxheti publik dhe nga donacionet individuale nën disa kufizime strikte cilësore dhe sasiore por jo edhe nga sfera e biznesit. Një model i tillë aplikohet në Francë të cilin do ta trajtojmë ndaras më tutje.

Modeli i financimit publik, ka për tipar kryesor financimin e partive politike nga buxheti publik duke ua dhënë mundësinë që të jenë të liruara nga detyrimet e grupeve të interesit dhe financuesve privatë. Në analizën krahasuese, është marrë për bazë Norvegjia e cila aplikon një model të tillë.

Modeli i financimit të hapur, apo modeli amerikan, paraqet drejtimin tjetër të tipologjive të financimit, i cili karakterizohet nga mundësitë e mëdha të kandidatëve dhe partive politike për të ngritur fonde nga individët dhe bizneset e shumta.

4.1 Franca – Kufizimet e financimit.

Kërkesat e gjata të popullit francez për një model të mirëfilltë kushtetues që u konsoliduan në të tashmën Republikën e Pestë, shpesh herë kanë ardhur jo vetëm si rezultat i logjikës që ka shpikur republikën por si rezultat i nevojave që kanë dalë gjatë ndërtimit të saj. Edhe aspekti i financimit të politikës në Francë është konsoliduar si nevojë. Në fakt Franca ishte ndër vendet e rralla brenda BE-së që nuk kishte paraparë ndonjë normë ligjore që do të specifikonte mënyrën e financimit të partive politike. U desh të ndodhin një mori skandalesh^{41,42} për të sjellë në vëmendje çështjen e financimit të partive. Me 11 Mars të vitit 1988 është nxjerrë ligji organik, përkatësisht Ligji 88/226 për Transparencën Financiare në Sferën Politike,⁴³ i cili ishte plotësuar më vonë me ligje të tjera. Sistemi francez i financimit të partive politike karakterizohet nga elementet si vijon:⁴⁴

- Donacionet nga personat fizikë janë të lejuara vetëm duke nisur nga viti para zgjedhjeve dhe jo përgjatë tërë ciklit të një mandati;
- Donacionet dhe kontributet që tejkalojnë shumë prej 150 Eurosh, duhet të jepen përmes transaksioneve bankare;
- Çdo donacion për kandidatin duhet t'i jepet personit të autorizuar për financa dhe asnjëherë vetë kandidatin;
- Para e gatshme (cash) që një kandidat apo parti mund të pranojë, nuk mund të tejkalojë 20% e shumës së autorizuar për shpenzime në fushatë;
- Kandidati që kandidon në zgjedhje nuk ka kufizime për të shpenzuar të holla nga vetë kontributi i tij;

41 D. Della Porta and Y. Meny "Democracy and Corruption in Europe" Pinter, 1997, fq. 19;

42 Ndër më të njohurat skandale është "Afera Luchoire" në të cilën kompania e armëve Luchoire i kishte shitur Iranit gjysmë milion mbushje artilerie edhe pse Franca kishte vendosur sanksione për shitjen e armëve ndaj Iranit. Megjithatë, ministri i Mbrojtjes nën presidencën e Mitterandit, Charles Hernu kishte heshtur skandalin në këmbim të një donacioni prej 500 mijë dollarësh nga kompania në fjalë; <http://www.nytimes.com/1987/11/08/world/arms-scandal-puts-mitterrand-on-defensive.html>;

43 Shih publikimin: <https://www.loc.gov/law/help/campaign-finance/france.php#f>;

44 <https://www.loc.gov/law/help/campaign-finance/france.php#f>;

- Asnjë entitet ligjor (biznese, korporata, sindikata) nuk lejohet që të financojë një kandidat politik;
- Asnjë entitet ligjor nuk mund të ofrojë të mira dhe shërbime për një kandidat politik dhe nuk mund t'i shesë shërbime apo mallra nën vlerën e tregut;
- Modeli francez aplikon kufijtë e shpenzimeve për fushatë duke caktuar shumën maksimale që mund të shpenzojë një parti apo kandidat gjatë zgjedhjeve;
- Financimi publik bëhet në mënyrë direkte, ku kandidatët marrin 1/20 e shumës maksimale të shpenzimeve para zgjedhjeve; si dhe financimi indirekt i cili nënkupton që shteti ofron hapësirë mediale të barabartë për të gjithë kandidatët pa pagesë, në televizionet, radiot dhe mjetet tjera të komunikimit gjatë fushatës zgjedhore;
- Një vit para zgjedhjeve kandidati cakton një person të autorizuar për të mbledhur, shënuar dhe menaxhuar me paratë e fushatës. Pas përfundimit të fushatës, kandidati duhet të dorëzojë në Komisionin e Zgjedhjeve raportin e detajshëm të të hyrave dhe shpenzimeve. Në rast se Komisioni Zgjedhor vëren parregullsi në raport, i njëjti publikohet në gazeta zyrtare për opinionin si dhe njoftohet Prokuroria për të konstatuar shkeljet e mundshme;
- Në rast se kandidati shkelë rregullat e përgjithshme që kanë të bëjnë me kufijtë e shpenzimeve, raportimin e financave, blerjen e hapësirës mediale apo të ngjashme, ai mund të dënohet me gjobë që fillon nga 3,750 Euro, deri me burgim prej një viti;

Siç mund të shohim, modeli francez ofron një hapësirë transparente dhe të barabartë për të gjithë aktorët politik, pavarësisht se kufizon shumë aspekte, për zbatimin e dispozitave ligjore është përgjegjës Komisioni i Zgjedhjeve dhe se nga koha kur këto masa janë në fuqi kanë evituar skandale. Shkëputja e financimit të kandidatëve dhe partive nga sfera e biznesit, paraqet një nga të arriturat themelore të këtij sistemi.

4.2 Shtetet e Bashkuara të Amerikës – Financimi me lobim.

Modeli amerikan i financimit të politikës karakterizohet nga një tipologji evolutive. Duke u nisur nga provizionet e Ligjit 92-255⁴⁵ të vitit 1971, u caktuan masat dhe kufizimet ligjore së bashku me penalltitë përcjellëse për kushtet e financimit të partive dhe kandidatëve me theks të veçantë gjatë fushatave zgjedhore. Ndër masat e parapara të këtij ligji përfshiheshin:

- Ndalimi i premtimeve për punësim si kompensim për mbështetje politike;
- Kufizimet e shpenzimeve për kandidatë varësisht për llojin e zgjedhjeve që kandidon;
- Ndalimi dhe financimi i kandidatëve nga bizneset që kishin marrëdhënie kontraktuale me institucionet publike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
- Çdo donacion që tejkalon shumën prej 10 dollarësh duhet të raportohet përfshirë emrin e donatorit dhe adresën;
- Ruajtjen e faturave të shpenzimeve dhe identifikimin e çdo donatori si dhe raportimin e tyre në Komisionin e Zgjedhjeve;

Karakteristikë e këtij ligji ishte fakti se pavarësisht disa kufizimeve, ai lejonte që kompanitë, bizneset dhe individët të financonin masivisht partitë politike dhe kandidatët për fushata zgjedhore. Pas diskutimeve dhe një numri opinionesh që dominuan vitet e 90-ta, në vitin 2002 u nxorr Ligji 107-155 i njohur si Ligji Bipartisan për Reformën e Fushatave Zgjedhore.⁴⁶ Ligji trajtoi në esencë reduktimin e ndikimit të grupeve me interesa të veçanta, përkatësisht korporatave dhe bizneseve si dhe kufizoi disa aspekte të financimit direkt. Megjithatë, edhe pse ligji i ri parashihte kufizime sa i përket financimit nga korporatat, në praktikë, një gjë e tillë ka qenë vështirë të parandalohet për shkak të veprimit të Komiteteve të Veprimit Politik, të cilat ishin

45 Ligji Federal për Fushatat Zgjedhore: <https://www.gpo.gov/fdsys/pkg/STATUTE-86/pdf/STATUTE-86-Pg3.pdf>

46 Shih ligjin: <https://www.gpo.gov/fdsys/pkg/PLAW-107publ155/pdf/PLAW-107publ155.pdf>



adresë e korporatave dhe bizneseve. Komitetet e Vepërimit Politik⁴⁷ janë fuqizuar edhe pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të SHBA-ve në rastin Citizens United,⁴⁸ sipas të cilit, ndalimi i korporatave dhe bizneseve për të financuar kandidatë, bie ndesh me Amendamentin e Parë të Kushtetutes, atë për Lirinë e Shprehjes. Sot, modeli amerikan i financimit të partive dhe kandidatëve politikë konsiston në parametrat e tillë si në vijim:

- **Financimi publik:** Për partitë politike dhe kandidatët për zgjedhje në nivel federal, ekziston një buxhet publik i dedikuar. Ky buxhet përgjithësisht mbulon financimin e konventave të nominimit të partive më të mëdha, si dhe një ndarje të konsoliduar të buxhetit për fushatat e të nominuarit të partive më të mëdha. Edhe për kandidatët individual në fazat e ciklit politik ekziston një formulë e mbështetjes financiare por e cila arrihet vetëm pas plotësimit të disa parakushteve, siç janë aftësia e kandidatit për të ngritur vetë një shumë të caktuar të fondeve proporcionalisht nga 5000 dollarë në 20 shtete;
- **Financimi nga jashtë:** Partitë politike dhe kandidatët për zgjedhjet në nivel federal, dhe më poshtë, kanë mundësi ligjore dhe aplikojnë në vazhdimësi ngritjen e fondeve nga bizneset private dhe individët.

Modeli amerikan shihet me dyshim nga komentues dhe ithtarë të egalitarizmit për shkak të mundësisë së influencimit të drejtpërdrejtë të grupeve të interesit tek ligjvënësit dhe kandidatët politikë në nivele të ndryshme federale. Megjithatë, i njëjti ka edhe avantazhet e veta për shkak se siguron një konkurrencë të vazhdueshme të përcjellë me kërkesa cilësore në politikën publike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

4.3 Norvegjia – Liria nga interesat

Nëse modelin francez mund ta karakterizojmë si një model kufizues, atë amerikan si një model mundësish, modeli norvegjez mund të përshkruhet si një model alternativ dhe për kapacitetet e buxhetit për një vend të zhvilluar, mbase edhe modeli më i përshtatshëm. Ky model është gjeneroz nga pikëpamja e financimit të partive politike me fonde publike.

Ligji për Partitë Politike,⁴⁹ miratuar në vitin 2005 partitë politike i konsideron si entitete private për çka edhe nuk parasheh ndërhyrje të drejtpërdrejtë në shumë çështje, përjashtuar financimin e tyre. Kapitulli 3 i Ligjit përcakton kategorinë e granteve për partitë politike. Shuma e granteve për partitë politike përcaktohet nga Stortingu (Parlamenti). Grupet/kandidatët e partive politike të zgjedhur në parlament financohen nga parlamenti, ata të zgjedhur në nivel komune nga komuna. Ligji parasheh që grantet e dedikuara për partitë politike dhe kandidatët të mos u imponohen rregulla që bien ndesh me pavarësinë e partive politike,⁵⁰ si dhe lirinë për t'i menaxhuar ato konform nevojave të partive politike.⁵¹ Gjeneroziteti i modelit shihet edhe tek mundësia që u lihet partive politike për të aplikuar për grante qeveritare. Grantet qeveritare janë adresa në të cilat partitë politike bazuar në fuqinë e tyre të votave, duke filluar nga 2.5 % e votave të fundit apo posedimit të së paku një ulëseje në parlament, mund të aplikojnë për grante qeveritare për të organizuar shtrirjen e tyre dhe funksionimin mbi baza të rregullta. Edhe forumet rinore të partive politike janë të stimuluar të aplikojnë për grante qeveritare. Po ashtu edhe partitë politike që janë të organizuara vetëm në nivelin lokal janë valide për të aplikuar për grantet qeveritare.

47 Shih shpjegimin: http://www.fec.gov/ans/answers_pac.shtml;

48 Shih rastin: https://en.wikipedia.org/wiki/Citizens_United_v._FEC;

49 Act 2005-06-17, no. 102; Political Parties Act of Norway: <http://www.legislationline.org/topics/country/11/topic/16>;

50 Ligji Nr. 102 për Partitë Politike, kapitulli 3, neni 10, pika 3; <http://www.legislationline.org/topics/country/11/topic/16>;

51 Po aty, kapitulli 3, neni 10, pika 4;



Nëse modelin francez mund ta karakterizojmë si një model kufizues, atë amerikan si një model mundësish, modeli norvegjez mund të përshkruhet si një model alternativ dhe për kapacitetet e buxhetit për një vend të zhvilluar, mbase edhe modeli më i përshtatshëm. Ky model është gjeneroz nga pikëpamja e financimit të partive politike me fonde publike.

Krahas tyre, ligji parasheh edhe financimin nga burime të tjera duke kufizuar vetëm:⁵²

- Donacione nga persona fizikë dhe juridikë të panjohur;
- Entitetet ligjore që kontrollohen nga shteti apo ndonjë institucion publik;
- Donatorë të jashtëm që nuk janë shtetas norvegjez;

Ligji përcakton edhe obligimet për raportimin e financave të partive politike për çdo vit kalendarik, përfshirë të hyrat dhe shpenzimet. Përjashtim kanë vetëm partitë të cilat gjate një viti nuk kanë ngritur fonde më të mëdha se 1,300 Euro (12,000 Kruna Norvegjeze).⁵³ Po ashtu ligji kërkon regjistrimin e çdo transaksioni dhe pranimi të të mirave qoftë si mallra apo shërbime në një sistem të llogarie. Identifikimi i donatorëve kërkohet veçanërisht për donacionet që kalojnë shumën prej 30,000 krunash apo 4,000 eurosh.

Ligji parasheh që autorizimet kryesore për zbatimin e tij janë nën ombrellën e Komisionit për Ligjin për Partitë Politike, një institucion i pavarur që monitoron dhe kontrollon zbatimin e ligjit. Në konstatimet e shkeljeve të mundshme të provizioneve të ligjit, partive politike do t'u ndalen mjetet nga grantet qeveritare.

Siç mund të shihet, partitë politike në Norvegji kanë mundësi të sigurojnë mbështetje financiare nga buxheti publik pa qenë domosdoshmërisht të varura nga grupet e caktuara të interesit. Ky model, mundëson një pavarësi të plotë të partive politike nga lista e ngushtë e interesave të korporatave duke i bërë ato të afta për të garuar me agjenda të mirëfillta politike që përfaqësojnë interesin e përgjithshëm.

Të tre modelet e shtjelluara më lartë janë marrë si referencë të tipologjive ekzistuese që rregullojnë çështjen e financimit të partive politike dhe transparencën e tyre. Kosova me legjislacionin ekzistues reflekton të jetë një model i përzier por që natyra e problemeve që hasen në përditshmërinë e implementimit të ligjit siç janë shtruar më lartë sugjerojnë se ndryshimet dhe përcaktimi për një model më të fuqishëm janë të nevojshme.

Në pjesën vijuese, janë dhënë disa prej rekomandimeve themelore analitike që do të ishin hapa të nevojshëm në procesin e reformimit të legjislacionit dhe mendësisë sistimore për një financim të drejtë, të barabartë, transparent dhe të qëndrueshëm të partive politike në Republikën e Kosovës.

52 Po aty, kapitulli 4, neni 17;

53 Po aty, kapitulli 4, neni 18;



4. PËRFUNDIME

ANALITIKE DHE

REKOMANDIME

THEMELORE

Pikënisje e shtjellimit të çështjes së financimit të partive politike në Kosovë ka qenë realiteti i cili sugjeron se partitë politike dhe personat e fuqishëm brenda tyre kanë potenciale të mëdha financiare të cilat i sigurojnë në rrugë jo transparente, obligimet ndaj të cilave burime ata i kthejnë përmes shpërbllimit me kontrata publike, favore personale, dhënie licencash dhe ndikim vendimesh etj. Ky problem, në rastin e Kosovës karakterizohet edhe me lidhjen reale me problemet e tjera në kuadër të sundimit të ligjit, siç janë korrupsioni, tenderomania dhe patronazhi politik. Një zgjidhje e mundshme që do të evitonte problemet e kësaj natyre në raportin e pushtetit të parasë dhe pushtetit të politikës, natyrisht se është disiplinimi i nevojshëm që prodhon rezultate. Ndonëse nga perspektiva teorike e dëshmuar globalisht, mund të kuptojmë se vetëm vendosja e normave nuk është e mjaftueshme për zbatimin e transparencës së financave të partive politike, prandaj duhet një qasje dhe gatishmëri ndërinstitutionale si dhe përfshirje të akterëve të pavarur siç është shoqëria civile.

Në perspektivën e normave ligjore, parimisht nuk mund të thuhet se ka mekanizma të drejtë dhe të gabuar në mënyrën se si legjitimohet financimi i partive politike. Edhe legjislacioni i Kosovës që rregullon këtë fushë nuk mund të cilësohet teknikisht si i mirë ose jo. Është shkalla e përshtatjes së realitetit ekzistues me normat ligjore, ai që në të vërtetë dëshmon funksionimin ose jo të tyre.

Me idenë se ligjet nuk janë norma që bëhen në “vakum” por që iu përgjigjen realiteteve socio-politike, më poshtë janë dhënë rekomandimet themelore që do të shtynin përpara agjendën e zbatimit të mirëfilltë të legjislacionit në fushën e financimit të partive politike:

Rekomandimet Themelore:

01

Përcaktimi i Modelit të Financimit

Parë nga praktika bashkëkohore, Kosova ka nevojë që të përcaktojë fillimisht një model e pastaj të përpilonte bazën ligjore për ta jetësuar modelin në fjalë. Në të kundërtën, një përzjerje modelesh siç është rasti me sistemin aktual, nuk ka dhënë efekte.

02

Rishqyrtimi i Legjislacionit

Duke pasur parasysh ligjet aktuale dhe shkallën e ultë të implementimit të tyre, është e nevojshme që të shtrohet në rishikim legjislacioni bazik, me theks të veçantë në definimin e plotë të një mekanizmi institucional që do të merrej me mbikëqyrjen e zbatimit të tij. Në këtë vijë, është e nevojshme të rishqyrtohen kompetencat e KQZ-së dhe të adresohen veçanërisht kompetencat e AKK-së për mandatin e monitorimit, hetimit dhe parandalimit të shkeljeve ligjore mbi financimin e partive politike;



03

Fuqizimi i Integritetit dhe Fuqisë së Ligjit

Në kuadër të ndryshimeve ligjore, të zgjerohen sanksionimet e nevojshme në mënyrë që ky ligj të jetë referencë e mirëfilltë që siguron hapësirë për të vepruar por njëkohësisht parandalim dhe ndalim të të vepruarit kundrejt normave ligjore. Kjo mund të bëhet përmes prezantimit të një morie masash të theksuara si p.sh.:

- Asnjë pranim i fondeve nga partitë politike që tejkalon shumën prej 1,000 eurosh të mos pranohet pa një përshkrim të prejdardhjes nga ana e donatorit qoftë si individ apo si entitet juridik. Në rast të shkeljes së kësaj dispozite, partitë politike të gjobiten me trefishin e shumës të cilës nuk i është dëshmuar prejdardhja.
- Autorizimi i KQZ-së që të gjitha raportet financiare të partive politike t'i bëjë publike, si tema të veçanta dhe me interes për publikun, përfshirë edhe rastet që janë duke u hetuar për shkelje ligjore, gjobat e lëshuara si dhe procedurat e nisura ndërmjet palëve;
- Monitorimi i donacioneve të partive politike përmes raportimit mujor vetëm të të hyrave nga donacionet tek AKK-ja, në mënyrë që të verifikohen nëse donatorët e ndryshëm kanë bërë shkelje ligjore siç p.sh.: kanë marrëdhënie kontraktuale me qeverinë dhe institucionet publike në kohën kur kanë dhënë donacionin apo brenda kohës që ligji e parasheh si shkelje;

04

Zbatimi i Masave Ligjore Ekzistuese

Përderisa ligji sanksionon kufizime dhe selekton burimet legale se nga ku mund të financohen partitë politike, deri më tani, këto masa nuk janë zbatuar, veçanërisht kur bëhet fjalë për financimet nga jashtë. Partitë nga komunitetet, me theks të veçantë komuniteti serb siç janë Lista Srpska, kanë lidhje direkte financimi me qeverinë e Serbisë dhe kjo çështje nuk është marrë në konsideratë asnjëherë nga mekanizmat e zbatimit të ligjit, praktikë kjo e dëmshme, në kundërshtim të plotë me ligjin dhe diskriminuese në të gjitha mënyrat;

05

Definimi i Terminologjisë dhe Obligimeve të Partive Politike

Në rastet e shumta, ka ambiguitet në të kuptuarit e procedurave, përgjegjësive dhe dispozitave që iu referohen partive politike. Në ligjin ekzistues madje nuk njihet e tërë terminologjia që karakterizon çështjen e partive politike në raport me financat e tyre. Për këtë shkak, duhet hartuar një terminologji gjithëpërfshirëse në të cilën kuptimet si: donacion, kontribut, shpenzime elektorale, periudha e fushatës elektorale, raportimi, etj. duhet të definohen dhe të lidhen me përgjegjësi direkte me partitë politike;



06

Auditimi si Kategori Produktive

Auditimet e bëra deri më tani në situatën optimale kanë mundur vetëm të konstatojnë ato të dhëna që partitë kanë paraqitur në raportet e tyre financiare. Në esencë, një auditim konstatues nuk paraqet asnjë ndikim real në çështjen e disiplinimit të partive politike kur është fjala për financat e tyre. Për këtë shkak auditimi duhet të jetë i inkorporuar brenda ligjit si një kategori e veçantë që ka fuqi jo vetëm konstatuese por nxitëse dhe implementuese. Për këtë shkak, është e nevojshme që auditimi të kryet në një format të ri. Ai duhet të kryhet jo vetëm përmes shqyrtimit të dokumentacionit të raporteve financiare vjetore, por duhet të dalë edhe në terren, sidomos gjatë fushatave zgjedhore, që të japë instruksione dhe të monitorojë nga afër mënyrën e menaxhimit të financave gjatë fushatave.

07

Investigimi

Ligji nuk do të kishte kuptim në rast se nuk ekziston i definuar qartë një mekanizëm që ka kompetenca për të kryer hetime për shkelje të mundshme ligjore. Kompetencat e nevojshme në këtë rast duhet të përfshijnë hetimin, padinë, gjykimin dhe dënimin në mënyrë që ligji të jetë i plotfuqishëm.

08

Përfshirja e Akterëve të Jashtëm

Sado i fuqishëm të jetë një mekanizëm institucional për të hetuar, parandaluar dhe zbatuar masa ndaj shkeljeve të mundshme në raportin parti politike – burime të financimit, prapë se prapë vetëm një mekanizëm institucional e ka të pamundur të jetë i gjithë vëmendshëm. Për këtë shkak, veçanërisht në natyrën e problemit që shtrohet këtu, është e nevojshme përfshirja e shoqërisë civile si një vëzhgues i jashtëm i sjelljeve të partive politike në raport me burimet e financimit të tyre, aftësisë së partive politike për të nd-

jekur procedurat e parapara formale, si dhe monitorimit të përgjithshëm të zbatimit të ligjit. Shoqëria civile është akter i fuqishëm që mund të kontribuojë në përsheptimin e zbatimit të ligjit, përmes presionit të ushtruar nga monitorimi dhe përcjellja e realitetit ekzistues.

09

Përcaktimi i Tavanit të Shpenzimeve për Fushatë

Një masë që është në vijë me logjikën e përgjithshme të përgjegjshmërisë së partive politike dhe transparencës së financimit të tyre, është edhe përcaktimi i tavanit të shpenzimeve gjatë fushatave zgjedhore. Nëse buxheti publik që pranojnë partitë politike bëhet në një formulë duke llogaritur një shumë për kokë banori, do të ishte e udhës që një formulë e tillë të aplikohet edhe si kufiri që një parti politike mund të shpenzojë gjatë fushatës zgjedhore.

10

Raportet Individuale të Shpenzimeve.

Është e nevojshme që pas përfundimit të fushatave zgjedhore, jo vetëm partitë politike por edhe kandidatët në listat zgjedhore të dorëzojnë një raport për shpenzimet e bëra gjatë fushatës. Kjo masë do të forconte edhe më tej kredibilitetin në kandidatët e përveçëm e në anën tjetër do të ishte një masë për të monitoruar përputhjen e shpenzimeve të kandidatit me buxhetin e përcaktuar të partive politike në përgjithësi.

Disiplinimi dhe transparenca e partive politike do të sillte një dobi të jashtëzakonshme dhe esenciale për demokracinë. Këto masa do të ndikonin në rritjen e lirisë së gjyqimit të qytetarit dhe selektimit të mbështetjes për partitë politike jo më mbi bazën e barrës së ngushtë të raporteve merr-jep, por mbi bazën e preferencave të njëmenda ideologjike dhe programore.

Përderisa ligji sanksionon kufizime dhe selekton burimet legale se nga ku mund të financohen partitë politike, deri më tani, këto masa nuk janë zbatuar, veçanërisht kur bëhet fjalë për financimet nga jashtë.



